



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 25, datë 22.04.2022

PËR

MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË ANEKSIT NR.1, TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR.32, DATË 26.03.2021 “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT PËR 4 BANESA KOLEKTIVE, L.17, RRUGA “LURA”, PALLATET NR.1&3, DHE RRUGA “AHMET DAKLI”, PALLATET NR.15&23, TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019” DUKE PËRFSHIRË Z.MARLIN SHKODRA

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, Ligjit nr.44/2015, “Kodi i Proçedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me Ligjin nr.97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 27.11.2019, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë”, të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe proçedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të proçesit të rindërtimit” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të proçedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 32, datë 26.03.2021 “Për miratimin e ndryshimit të listës së përfituesve nga programi i proçesit të rindërtimit për 4 banesa kolektive, l.17, rruga “Lura”, pallatet nr.1&3, dhe rruga “Ahmet Dakli”, pallatet nr.15&23, të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”, Urdhërit nr. 135, datë 01.03.2021 të Kryetares së Bashkisë “Për ngritjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave të aplikantëve jofitues që nuk janë përzgjedhur nga programet e proçesit të rindërtimit me nivel dëmi DS4-DS5”, si dhe sipas relacionit të hartuar nga ky komision, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të Aneksit nr.1 “Pallati nr. 23 (989), Rruga “Ahmet Dakli”, të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 32, datë 26.03.2021 “Për miratimin e ndryshimit të listës të subjekteve përfituesve, që do të përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit për 4 banesat kolektive, l.17, rruga “Lura”, pallatet nr.1&3, dhe rruga “Ahmet Dakli”, pallatet nr.15&23, të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”.
2. Miratimin e ndryshimit në Aneksin nr.1, pjesë përbërëse e Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.32, datë 26.03.2021 përsa i përket klasifikimit si përfitues të z. Marlin Shkodra në masën e strukturës së njësisë së banimit 2+1, sipas relacionit hartuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave të aplikantëve jofitues, që nuk janë përzgjedhur nga programet e procesit të rindërtimit me nivel dëmi DS4-DS5, Bashkia Durrës.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Bashkia Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.



KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 22.04.2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 381/prot.
4



Durrës, më 05.05.2022

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK ✓
DURRËS



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.25 datë 22.04.2022 “Për miratimin e ndryshimit të Aneksit Nr 1 të VKB Nr 32 dt 26.03.2021 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit për 4 banesa kolektive L17 Rr Lura, Pallatet nr 1 dhe 3 dhe Rr. Ahmet Dakli, Pallatet nr 15 dhe 23, të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019” duke përfshirë Z.Marlin Shkodra.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI